



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 43/18  
Prishtinë, më 30.01.2019, në orën 15:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhjen e përbashkët morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Dardan Molliqaj, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Enver Hoti dhe Blerim Kuqi.

Munguan: Naser Osmani dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës i ftuar: Fatmir Gashi – Zëvendësministër i Financave, Salvador Elmazi - Ministria e Financave, Milaim Aliu - Ministria e Financave, Arta Maxhuni nga MF.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetar i Komisionit (tutje Kryetari).

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-114, për Zyrtarët Publik dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari:** Kostatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

**2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

**Rekomandim**

1. Projektligji nr.06/L-113, për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin nr.06/L-113, për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-114, për Zyrtarët Publik dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

**Rekomandim**

1. Projektligji nr. 06/L-114, për Zyrtarët Publikë, përmban kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin nr. 06/L-114, për Zyrtarët Publikë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

**Kryetari:** Parimisht ky projektligj është dashur të trajtohet nga komisioni jonë pasi që ka të bëjë me paga dhe në pjesën më të madhe të procesit ne kemi qenë jashtë, të pa involvuar, ndonëse në seancë është kërkuar që të bëhet një grup i përbashkët në mes dy komisioneve dhe nuk është marrë parasysh. Tani nuk as hapësirë dhe as mundësi për të dhënë komente substanciale, në një kohë kaq të shkurtër.

**Mërgim Lushtaku:** Të njëjtin shqetësim e kam edhe unë për arsye se është një ligj i rëndësisë së veçantë dhe sigurisht është do të ishte mirë të kemi një diskutim më të gjerë dhe neve si komision duhet të kemi hapësirën e duhur që ta shqyrtojmë në tërësi. Megjithatë, meqenë se jemi një këtë situatë, unë po ngrisë një çështje që ndërlidhet me Ministrinë e Kulturës. Ministria e Kulturës ka hartuar një rregullore për krijuesit, performuesit e punojësve profesional të trashëgimisë kulturore, ku përfshihet edhe çështja e kompensimit të tyre, por qëkjo nuk është pasqyruar në këtë projektligj për pagat dhe as në amendamentet e komisionit funksional. Kështu që unë kërkoj që të mbështetet kërkesa e Ministrisë së Kulturës për krijuesit, performuesit dhe punonjësit profesional të trashëgimisë kulturore.

**Kryetari:** Çfarë mund të bëjmë ne është të propozojmë amendament për komisionit funksional sepse ne nuk jemi komision që trajtojmë substancën e ligjit.

**Safete Hadergjonaj:** Unë propozojë që të bëjmë si amendament të komisionit edhe ja dërgojmë komisionit për administratë publike. Me sa unë diskutova me ata nuk janë shumë kundër me rregullu këtë çështje.

**Fatmir Gashi:** Ne kemi pasur një version të këtij projektligji për çfarë kemi përgaditur vlerësimin e ndikimit buxhetor dhe sipas këtij vlerësimi kostoja buxhetore për pagat arrin shumën 724.841.477 euro. Në këtë vlerësim nuk janë përfshirë amendamentet e komisionit funksional që kemi pranur sot. Prandaj, kisha kërkuar nga komisioni që ta jepë një afat deri nesër që departamenti i buxhetit në ministrinë së financave së bashku me departamentet e ministrisë së administratës publike të ulemi dhe të llogarisim të gjitha këto amendamente se si ndikojnë në këtë kosto dhe ta kemi një vlerësim të përgjithshëm për koston.

**Safete Hadergjonaj:** Ne mundemi me kalu raportin me këtë rekomandim me dërgu tek komisioni dhe me kërku prej Ministrisë së Financave me na e dërgu koston shtesë që ne si komision me ditë me detaje sa është ajo kosto buxhetore dhe në seancë i bashkëngjitet raportit përfundimtar të komisionit.

**Kryetari:** Kjo është një alternativë e mirë por unë jam për të kërkuar afat shtesë për me trajtu këtë punë. Edhe një herë Komisioni për Buxhet dhe Financa ky është ligji më i rëndësishëm që mund të na vijë ndonjëherë dhe nuk jemi konsultuar fare, për shkak të rrjedhave politike dhe jo logjike të trajtimit është sjellur në këtë datë dhe është ndërlidhur me ligjin e buxhetit, përndryshe kjo nuk ka asnjë lloj urgjence tjetër.

**Dardan Molliqaj:** Megjithatë është edhe një fakt shtesë që projektyligji në lexim të parë ka kaluar me sa më kujtohet në nëntor, pra deputetët kanë votuar pro ose kundër dhe deri më tani i kanë pasur më shumë se dy muaj për të trajtuar ligjin. Ligji është kthyer për tu votuar në lexim të dytë pas kërkesës së PSD-së që lidhet me buxhetin që është ajo pjesa që ju thatë që është aspekti politik. Për ne si parti Social-Demokrate është e pranueshme çdo shtyerje por fjala shtyerje kupton shtyerje të votimit të buxhetit. Unë megjithatë mendoj se është e mjaftueshme dhe nuk besoj që ka probleme shumë serioze dhe sa më shpejtë që miratohet ky ligj kërkesat e paarsyeshme përfundojnë.

**Kryetari:** Dardan ne kemi dërguar komente si deputetë, por si komision kemi të drejtën me trajtu materien bashkë dhe kjo kohë është dy javore, nuk është kohë e orëve për këtë arsye po them që unë së paku nuk mund të bëjë komente serioze.

**Arbërie Nagavci:** Ne e kemi shqyrtuar ligjin që në lexim të parë dhe kemi pasur rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerimet tona. Projektyligji ka pësuar ndryshime të shumta dhe si u përmend këtu do të thotë 75 milio euro kostoja shtesë, pa i përmendur amendamentet e fundit, do të thotë se faktikisht ne pothuajse nuk po flasim për të njëjtin ligj sepse kemi më shumë çrregullime në sektorin publik se sa rregullim me këtë projektligj. Pra është e qartë që është kërkesë politike edhe nëse e votojmë mendimi im është që ne po i jepim hapësirë marrëveshjeve politike që kanë me kriju kriza edhe më të thella.

**Dardan Molliqaj:** Gjithë kohën që angazhohemi jemi në politikë gjithçka është politike. Me thënë që me këtë ligj është më i pa rregulluar sistemi i pagave në sektorin publik, ky mund të jetë qëndrim politikë dhe mundesh me thonë publik, por mendoj se nëse krahasojmë gjendjen si ka qenë deri më tani në çështjen e pagave, me këtë ligj është rregulluar dhe janë vë në sistem pagat në sektorin publik. Ky ligj ka rregulluar dallimet, ta zëmë Kryeministri i Kosovës tani do ti marrë 2000 e diqka euro në krahasim kur i ka pasur 2,950 euro. Pra është ngushtuar hendeku mes pagës së lartë dhe pagës së ulët, ka hy në sistem dhe ka një hierarki me ndonjë përjashtim, me e cilësu që tash ky ligj e bënë edhe më të keq mendoj që është e paqëndrueshme.

**Arbërie Nagavci:** Unë pajtohem që është domosdoshmëri me e pasur ligjin për paga dhe është shumë e rëndësishme për ta rregulluar çështjen e pagës, arsyeja është se për shkak të ngutisë e çrregullon edhe më shumë këtë sektor. Është pikërisht për faktin e ndërhyrjeve dhe planifikimit që është bërë prej fillimit dhe për këtë arsye ngutia për me u përfunduar për mendim timin do të shkaktojë më shumë pasoja dhe dëme se sa që ka me e pasë një trajtim të rregullt.

**Blerim Kuqi:** E para po flasë për procedurën. Ne nuk jemi komision funksional. Edhe pse është dashur të ishte e kundërta por kjo është një fakt. Dhe tani ne duhet të e trajtojmë në aspektin financiar. Për sa i përket ligjit, rregullon pagën bazë dhe shtesat. Paga bazë është me rëndësi për neve sepse me ligj jemi të obliguar me pagu çdo herë, përveç pagave të jashtëzakonshme. Unë si anëtar i komisionit dua të pyes se a ka mundësi të ndahen pagat veç dhe shtesat veç, shtesat nuk llogariten tash është e vështirë por një lloj përafrimi jo vetëm te pagat bazë por edhe shtesat me ligj thuhet se kosova ka obligim ligjor ndaj pagave bazë. Unë si deputet jam i detyruar që ti japë vërejtjet në seancë dhe mendoj që të bëhet një amendament kurse ne sot duhet të shikojmë vetëm aspektin financiar, zv.ministri tha se kosto ka pasur 75 milion euro tani nuk e di por në seancë duhet të kemi koston e ligjit të bashkangjitur rekomandimit të komisionit.

**Ali Lajçi:** Kostoja buxhetore çështje më rëndësi e këtij ligji dhe është e vërtetë që ne si komision nuk kemi pasur qasje në proces. Kurse kjo pjesa që e tha zv.ministri për nevojën e vlerësimit të koston është e domosdoshme dhe duhet të bëhet dhe të votohet.

**Enver Hoti:** Ajo që po më befason jo vetëm në komision por edhe në media edhe me qëndrimet tona politike që me vite të tëra kemi kërkuar ligje me paga dhe ligje për qeverinë dhe tani sikur po kemi ndonjë hezitim që ndoshta po mundohem me kursy ajo që po ndodh me grevat dhe me disa lëvizje që po ndodhin në Kosovë. Tani kur po afrohem tek një përmbyllje që mund të ketë probleme apo pengesa, por ajo me këtë ligj po jepen zgjidhje për problemet e shumë viteve.

**Fatmir Gashi:** Unë pajtohem me deputetin Dardam që më mirë të kemi diçka se sa asgjë fare. Ky ligj më së paku po ndërton një sistem në sektorin e pagave, i cili me siguri do të kërkojë nevojën, për ndryshime dhe plotësime në të ardhmen..

**Kryetari:** Theksoi se përveç propozimit të Mërgim Lushtaku, kemi edhe një propozim që është kërkesë e deputetit Naser Osmani, që të kërkojmë nivelimin e shtesave në mes inspektorëve të doganës, të ATK-së dhe inspektorëve hetues të të autoritetit të konkurrencës. Pra, ne të kërkojmë që shtohet teksti që edhe inspektorët hetues të autoritetit të konkurrencës, të kenë të drejtë në shtesa sikurse ata të ATK-së. Ne e kemi votuar herën e kaluar këtu në buxhet, por që nuk është reflektuar në këtë ligj.

**Safete Hadergjonaj:** Theksoi se dy propozimet që u bënë është më mirë ti quajmë amendamente sepse nëse nuk i përkrah komisioni funksional, atëherë ato procedohen në Kuvend.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, Kryetari konstatoi se komisioni 5 vota Për, 4 Abstenime dhe Asnjë Kundër, nxori këtë

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik, përmban kosto të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, për Projektligjin nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik, përmbajnë

kosto të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon dy amendamente me tekstin si në vijim:

#### **Amendamenti 1**

Neni 8, paragrafi 1, në nën-paragrafin 1.2., pas fjalës “zyrtarët doganorë”, shtohet teksti “zyrtarët e Administratës Tatimore dhe inspektorët hetues të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës”

#### **Amendamenti 2**

Në shtojcën 1 të Projektligjit, të ndryshuar me amendamentin 53 të Komisionit FunkSIONAL, bëhen ndryshimet si në vijim:

- Në pikën 153, në pozitën “Krijuesit dhe përfituesit e kulturës dhe të artit 1”, koeficienti nga 2.75., ndryshohet në 3.4.
  - Në pikën 154, në pozitën “Krijuesit dhe përfituesit e kulturës dhe të artit 2”, koeficienti nga 2.4., ndryshohet në 3.
  - Në pikën 155, në pozitën “Krijuesit dhe përfituesit e kulturës dhe të artit 3”, koeficienti nga 2., ndryshohet në 2.6.
  - Në pikën 156, në pozitën “Krijuesit dhe përfituesit e kulturës dhe të artit 4”, koeficienti nga 1.8., ndryshohet në 2.1.
  - Në pikën 157, në pozitën “Krijuesit dhe përfituesit e kulturës dhe të artit 5”, koeficienti nga 1.65., ndryshohet në 1.9.
4. Komisioni kërkon nga Ministria e Financave, që të bëjë një vlerësim të ri të kostos buxhetore të Projektligjit dhe amendamenteve të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, i cili vlerësim i është bashkangjitur këtij rekomandimi.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:30.**

**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

**Kryetari komisionit,**

-----  
**Lumir Abdixhiku**